


STATUT



I

SHOQERISE TREGTARE

**“INFRA SOLAR ” SHPK**

SELIA FIER

JANAR 2022

**STATUTI**  
**I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR “ Infra Solar ” sh.p.k.**

**I. Krijimi, forma, emertimi , Objekti , selia dhe kohezgjatja e shoqerise .**

**Neni 1**

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar “ **Infra Solar**”, eshte krijuar sipas Aktit te Themelimit qe i bashkelidhet ky Statut i perpiluar dhe nenshkruar nga ortaket e kesaj shoqerise, per sa me poshte vijon :

**Z.Valdrin Pjetri** , i datelindjes 18.09.1982, lindur ne Shkodër,mbajtes i leternjoftimit me personal nr. I20918140C dhe **Z.Bujar Hoxha**, i datelidnjes 25.05.1976, lindur ne Neshtë, mbajte i leternjoftimit me personal nr. H60425024P

**Neni 2**

Shoqeria zhvillon veprimtarione tregtare ne Shqiperi ne perputhje me legjislativi shqiptar ne fuqi dhe ne perputhje me dispozitat e ketij satuti. Shoqeria fiton personalitet juridik nga dita e regjitsrimit te saj .

**Neni 3**

**Emertimi i shoqerise eshte “ Infra Solar ” sh.p.k.**

**Neni 4**

**Shoqeria krijohet per te ushtruar aktivitetin e saj tregtar ne keto drejtime :**

**Shoqëria tregtare private “ Infra Solar ” sh.p.k, ka për objekt të veprimtarisë së saj:**

Implementimi dhe menaxhimi i projekteve gjeneruese te energjise elektrike solare (fotovoltaik) dhe energjise se eres (eolike) ne Republiken e Shqiperise dhe marja nga Qeveria Shqiptare apo Ministri i Institucioneve te Shtetit Shqiptar i te gjitha miratimeve, lejeve dhe licensave te cilat mundesojne zhvillimin e ketij aktiviteti ne menyre te qete dhe ne perputhje me kuadrin ligor ne Republiken e Shqiperise. Implementimi dhe menaxhimi i projekteve ne fushen e akuakultures dhe bujqesise si dhe veprave ndihmese qe lidhen me to , prodhimi, kultivimi, perpunimi, grumbullimi, transporti i produkteve te akuakultures. Import eksport te gjitha llojeve te materialeve dhe transport.

Konsulenca teknike ne te gjitha fushat.

Shoqeria ka te drejt te ushtroje çdo lloj aktiviteti te parashikuar nga ligji ne perputhje me rregullat e dispozitat ne fuqi. Shoqeria do te ushtroje aktivitetin e saj ne baze te autorizimeve dhe/ose lejeve perkatese te leshuara nga organet kompetente te fushes”.

**Neni 5**

Shoqeria “ **Infra Solar** ” sh.p.k., do te kete qendren ( seline ) e saj ne territorin e Republikes se Shqiperise , ne adresen : Rrethi Fier , Bashkia Fier , Lagja "Mbrostar Ferko" Rruga "Fier Celograd » Km 2, Godine dykateshe, me nr.pasurie 65/19.

Shoqeria, mund te hape filiale te saj ne te gjitha rrethet e vendit ne perputhje me dispozitat ligjore ne fuqi .

**Neni 6**

Shoqeria “ **Infra Solar** ” krijohet per te ushtruar veprimtarine e saj per një periudhe kohe te pakufizuar , mbi dhjete vjete pune te njepasnjeshme . Ky afat mund te shkurtohet per rastet kur shoqeria do te shperbehet sipas percaktiveve qe do te pasqyrohen ne Statut.

**II . Kapitali themeltar , Kontributi , pjeset e kapitalit themeltar .**

**Neni 7**

7/1 Kapitali baze i Shoqerise eshte ne para: 150.000 (njeqind e pesedhjete mijë) leke, ortaku Valdrin Pjetri, me 33 (tridhjete e tre) % pjesëmarrje në përqindje, dhe ortaku Bujar Hoxha, me 67 (gjashtedhjete e shtate) % pjesëmarrje në përqindje te kuotave te shoqerise.

Kontributi i ortakeve eshte në para dhe do te paguhet mbas regjistrimit te kesaj shoqerie ne QKB.

Ortaket per gjigjen per humbjet e shoqerise perkundrejt te treteve deri ne vleren e kontributit te tyre ne kapitalin themeltar te shoqerise;

7/2 Kapitali i shoqerise do te rritet krahas ecurise se saj ekonomike , financiare si dhe te vendimeve qe do te marrin ortaket eshoqerise per ta rritur ate ne te ardhmen.

7/3 Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme me rruge trashegimie , ne rast ndarje pasurore mes bashkeshorteve dhe nepermjet paraardhesve e pasardhesve sipas legjislacionit ne fuqi ne Republiken e Shqiperise.

7/4 Fitimi i shoqërisë i përket tërësisht ortakeve të shoqërisë .

Ky fitim do të disponohet lirisht prej tyre, ne baze te raportit te kontributit te tyre ne kapitalin themeltar, pasi të jenë shlyer më parë detyrimet tatuuese fiskale dhe ato ndaj të tretëve dhe te jene hequr 5% qe do te fuqet ne fondin e rezerves ligjore deri ne permbushjen e 1\10 te kapitalit te shoqerise .

### Neni 8

#### **III. Organet drejtuese të shoqërisë , Marrja e vendimeve , Administrimi , kompetenca dhe kontrolli i shoqerise .**

8 Organ drejtues dhe vendimor në këtë shoqëri ështe mbleasambleja e ortakeve.

8/1 Asambleja e ortakeve, merr vendime te zakonshme ose te jashte zakonshme sipas disponimeve te statutit te shoqerise .

8/2 **Shoqeria do te administrohet nga Administratori i saj Z.Bujar Hoxha, me atesi Beqir, i datelindjes 25.05.1976, lindur ne Neshtë, mbajtes i leternjoftimit me personal nr.H60525024P, i cili do te kete kete detyre per nje periudhe 5 (pese) vjecare, me te drejte rizgjedhje .**

Administratori e përfaqëson juridikisht atë në të gjitha organet apo organizmat e aparatit shtetëror dhe në marrëdhëniet me të tretët, kur veprimet kanë të bëjnë me disponimin e interesave materiale të shoqërisë.

8/3 Per cdo ceshtje profesionale, si juridike, ekonomike, teknike etj , shoqeria do te angazhoje sipas rastit ne menyre te vijueshme ose te perkoheshme duke punesuar specialist sipas legjislacionit ne fuqi .

### Neni 9

Administratori eshte perjegjes individualisht ose solidarisht sipas rastit ndaj shoqerise apo te treteve , per shkelje te ligjeve, te dispozitave te ketij statuti, apo per faje gjate administrimit te shoqerise .

### **NENI 10**

Disa nga kompetencat qe i jepen Administratorit jane :

Administratori ka të drejtë e detyrohet të:

a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit te zakonshem dhe te jashtezakonshem të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga ortaku i vetem,

b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;

c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;

ç) përgatisti dhe nënshkruej bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpala ortakut te vetem për miratim;

d) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrëthanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;

dh) kryejë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;

e) raportojë përpala ortakut te vetem në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;

Administratori eshte i detyruar të thërrasi mbledhjen e ortakut te vetem edhe ne rastet kur :

sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.

Administratori ka të drejtë të kryeje të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm e të jashtëzakonshëm.

Administratori përfaqëson Shoqërinë përpala të gjitha personave fizike e juridike, publike dhe/ose private vendas apo të huaj, autoriteteteve shtetërore Shqiptare apo të huaja, përfshi këtu autoritetet gjyqësore të gjitha shkallevet. Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, në të gjitha rrëthanat me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep shprehimisht ortakut te shoqerise.



Administratori angazhon shoqerinë në marrëdhëniet me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e tij.

Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretët e dinin që akti i administratorit e kalonte objektin e shoqërisë ose kur të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt në rrëthanat e dhëna, duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.

### **NENI 11 MBLEDHET E ASAMBLESE**

**Mbledhja e Asamblese**, janë te zakonshme dhe te jashtezakonshme

Mbledhjet e ortakut te vetem , te zakonshme duhet te thirren te pakten një here ne vit .

### **NENI 12**

1-Asambleja e e per gjithshme thirret nepermjete një njoftimi me shkresë ose me njoftim nepermjete postes elektronike i cili duhet te permblaje vendin , daten , oren e mbledhjes dhe rendin e dites e i dergohet ortakeve jo me vone se 7 dite perpara dates se parashikuar per mbledhjen e asambleze .

2-Kur Asambleja e per gjithshme nuk eshte thirrur sipas pikes 1 te ketij neni , ajo mund te marre vendime te vlefishme vetem nese te gjithe ortaket janë dakorte per te marre vendime , panvaresisht parregullsisë . Administratori emeron një sekretar per mbajtjen e procesverbalit .

Me autorizimin me shkrim te nenshkuar nga ortaket , shoqerine mund ta perfaqesoje cdo person tjeter .

### **NENI 13**

**Asambleja e ortakeve te shoqerise**, eshte per gjegjese per marrjen e vendimeve per shoqerine per ceshtjet e meposhteme :

- a- percaktimin e politikave tregtare te shoqerise
- b- ndryshimin e statutit
- c- emerimin e shkarkimin e administratorit ose administratoreve
- d- emerimin dhe shkarkimin e likuiduesve dhe te eksperteve kontabel te autorizuar
- e- percaktimin e shperblimeve per personat e permenduar ne shkronjat « c » dhe « d » te kesaj pike .
- f- mbikqyrjen dhe zbatimin e politikave tragtare nga administratori apo administratoreve , perfshire perqatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise
- g- miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise
- h- zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit
- i- pjestimin e kuotave dhe anulimin e tyre
- j- perfaqesimin e shoqerise ne Gjykatë dhe ne procedimet e tjera ndaj administratorit, apo administratoreve.
- k- riorganizimin dhe prishjen e shoqerise
- l- miratimin e rregullave proceduriale te mbledhjeve se ortakut te vetem.
- m- ceshtje te tjera te parashikuara nga ligji .
- n- Ben pranimin e anetareve te rinj te shoqerise .

### **NENI 14 LIBRAT E SHOQERISE**

Shoqeria eshte e detyruar te mbaje per vec dokumentacionit kontabel ose librave te tjere dhe keto libra :

1- Libri i ortakut ne te cilin shenohen emtri i plote i tij dhe kuota e kapitalit themeltar .

2- Libri i mbledhjeve dhe vendimeve te organit vendimor .

3- Libri i Mbledhjeve dhe vendimeve te organit administrativ .

### **IV , Viti Financiar dhe llogarite vjetore**

#### **NENI 15**

Viti finanziar fillon më 1 janar dhe mbaron më 31 dhjetor të çdo viti perjashtimisht viti i pare finanziar ka filluar diten e themelimit si person juridik .

## NENI 16

Llogaritë vjetore, inventari, raportet mbi operacionet e vitit finanziar dhe cdo raport tjetër i veçantë në këtë drejtim, te hartuara nga Administratori , nga eksperti kontabel pas shqyrtimit i paraqiten për miratim ortakeve të shoqërisë brenda tre muajve dhe në çdo rast, jo më vonë se tre muaj nga data e mbylljes së vitit. Bilanci vjetor i shoqerise nxirret brenda 31 marsit te vitit pasardhes .

## NENI 17

17/1 Veprimtaria ekonomike – financiare dhe tregetare e shoqerise realizohet dhe garantohet ne baze te legjislacionit ne fuqi ne Republiken e Shqiperise .

17/2 Per detyrimet e veta ne qarkullimin tregetar dhe juridik me persona te trete shoqeria per gjigjet me pasurite e veta .

17/3 Aktivi dhe pasivi i veprimtarise se Shoqerise pasqyrohet ne planet ekonomike – financiare dhe tregetare te saj te shprehura ne para shqiptare ose te konvertuara ne valute te huaj .

17/4 Pasurite e shoqerise vleresohej nepermjet bilanceve ekonomiko- financiare dhe tregetare te saj ,ne perputhje me dispozitat ligjore ne fuqi .

17/5 Te ardhurat e shoqerise pasi te zbriten shpenzimet e amortizimit te pasurise se palujteshme dhe te luajteshme si dhe shpenzimet e tjera qe behen ne interes te shoqerise ,i takojne ortakeve te shoqerise sipas dispozitave te percaktuara ne aktin e Themelimit dhe ne Statutin e krijimit te saj .

17/6 Detyrimet qe mund te lindin gjate veprimtarise se shoqerise ajo I mbulon nga fondi rezevre ose nga shumat suplementare. Shoqeria me per gjegjesi te kufizuar i perballon humbjet e saj deri ne kufirin e vleres se kapitalit te investuar ne te .

17/7 Pasuria e shoqerise do te sigurohet ne Institutin e Sigurimeve te Republikeve si dhe ne institute te tjera private ekzistuese apo qe do te krijohen ne te ardhmen sipas legjislacionitne fuqi .

17/8 Masa e pasurise qe do te sigurohet si dhe koha e sigurimit te saj do te vendoset nga Administratori I shoqerise .

## Neni 18

Mjetet e investuara për themelimin e shoqërisë si dhe ato të shtuara nga aktiviteti i saj i zgjeruar regjistrohen në librin afarishtë shoqërisë menjëherë. Shoqëria është pronare, përdoruese, disponuese e pasurive në emër të vet në përputhje me qëllimin dhe objektin e veprimtarisë së saj.

## V . Dividentet

### NENI 19

Pas mbarimit te llogarive vjetore dhe te evidentimit te ekzistences se fitimit ,percaktohet pjesa qe iu takon ortakut themelues ne formen e dividentit mbi fitimin . Ky fitim perbehet nga : fitimi i vitit finanziar te cilit i jane zbritur shumat e lena menjane per fondon e lene rezevre te domosdoshem te percaktuar nga ortaket ,te fondeve te tjera qe shihen te nevojshme dhe nga ana tjeter Jane zbritur ose Jane shtuar respektivisht humbjet apo fitimet e mbartura nga vitet e meparshme .

## Neni 20

Pasuritë e shoqërisë vleresohej me bilancet e saj, me vlera të shprehura në monedhë shqiptare dhe të huaj, në përputhje me dispozitat ligjore përkatëse të zbatuara në Shqipëri. Shkëmbimi i monedhës shqiptare me të huaj dhe e kundërtë bëhet në përputhje me kursin e caktuar nga Banka në momentin e këmbimit të saj.

## VI. Punesimet ne shoqeri

### Neni 21

Marrëdhëniet e punës në shoqëri rregullohen nëpërmjet kontratës së punës, e cila mund të jetë kolektive dhe individuale. Cështjet të cilat nuk gjijnë rregullim në kontratat e punës zgjidhen sipas legjislacionit shqiptar: Kodi i Punës dhe cdo akt tjeter ligjor e nënligjor që ka të bëjë me këtë çështje.

## Neni 22

I punësuari nuk merr pjesë në ndarjen e fitimit të cilin e realizon shoqëria gjatë veprimtarisë së saj apo edhe në humbjet e saj, nëse në kontraten e punës nuk është përcaktuar ndryshe.

Ai përgjigjet materialisht për dëmet që i shkakton shoqërisë me faj.

## VII . Shpërbërja dhe likuidimi i shoqërisë.

### Neni 23

Shoqeria prishet para kohe kur :

1. Aktiviteti ekonomik i saj per disa vjet radhazi eshte ne humbje .
2. Per arsyte parashikuara ne ligj .
3. Veprimi i kushteve te forcave madhore .
4. Dalja e nje vendimi nga Organet kompetente qe ndalon veprimtarine e saj .

Shoqëria hyn në procesin e likuidimit të saj qysh në momentin e prishjes ose të shpërbërjes.

Per kryerjen e ketij procesi ortaket caktojne nje ose disa likujdues te cilet i paraqesin asamblese raportin mbi gjendjen e aktivit dhe te pasivit te shoqerise ,mbi ndjekjen e operacioneve te likuidimit dhe mbi afatet e nevojshme te perfundimit te tyre .

Ne fund te procesit te likuidimit ortaku i vetem, vend mbi bilancin perfundimtar financier dhe mbi mbylljen e procesit te likuidimit .

Pas pagimit te kreditoreve dhe te shlyerjes, kapitali themeltar kontribues dhe gjithe kapitali finaciar e material i mbetuar , i kalon ortakut te vetem .

## XIII . Zgjidhja e mosmarreveshjeve

### Neni 24

Zgjidhja e mosmarreveshjeve qe mund te lindin gjate veprimtarise se shoqerise do te zgjidhen me mirekuptim ,e nese kjo nuk arrihet atehere pala e interesuar mund ti drejtohet organeve kompetente te juridiksonit te vendit ku kane lindur mosmarreveshjet .

## IX. Dispozita te pergjithshme

### Neni 25

Ne rast se ne Republiken e Shqiperise shpalen ligje, dekrete, ose vendoset nje politike me e favoreshme nga legjislacioni i pasqyruar ne Aktin dhe Statutin e krijimit te Shoqerise atehere ortaku i shoqerise ka te drejten t'u drejtohet organeve perkatese shteterore qe te zbatojne legjislacionin me te favorshem per shoqerine e krijuar .

## X . Dispozita te vecanta

### Neni 26

26/1 Te gjitha dokumentat e shoqerise do te permbojne adresen e plote te saj ,numrin e rregjistrimit ne Rregjistrin Tregetar te QKB , Numrin Unik te Identifikimit per ushtrimin e veprimtarine e saj .

26/2 Per ceshqje te tillë qe nuk parashikohen ne Statut ,veprimtaria e shoqerise do te bazohet ne legjislacionin perkates ne fuqi ne Republiken e Shqiperise .

## HYRJA NE FUQI

### Neni 27

27/1 Ky Statut i perpiluar nga une Ortaku ne 4 ( kater ) kopje te barabarta , hyn ne fuqi qysh ne momentin e nenshkrimit nga ana ime ne Zyren Noteriale Fier ku depozitohet edhe kopja e pare .


27/2 Ne rastet e likuidimit perfundimtare te shoqerise ,sipas legjislacionit ne fuqi ,pushon se vepruari edhe ky Statut i saj .

27/3 Krahas persosjes se metejshme te legjislacionit tregetar , si dhe te ecurise se veprimtarise se shoqerise, ortaku i vetem ka te drejten e permiresimit te metejshem dhe te dispozitave te ketij Statuti dhe te te gjithe dokumentave te Shoqerise duke bere depozitimet perkatese sipas legjilacionit ne fuqi .

### ORTAKET E SHOQERISE

Valdrin Pjetri perfaqesuar nga i besuari Bujar Hoxha

Bujar Hoxha

  
Bujar Hoxha



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË  
DEGA VENDORE VLORË

NOTER ANILA HAXHIU  
ADRESA Lagjia 29 Nentori, Rruga  
Kastriot Muco, Godina 1  
TEL: 0696585135

## VERTETIM NENSHKRIMI (STATUTI)

Nr. repertori: 394

Fier më 26/01/2022

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë"



V2022062450008376302

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË  
DEGA VENDORE VLORË<sup>1</sup>  
NOTER ANILA HAXHIU**



**DATE 26/01/2022  
NR REP 394**

**VËRTETIM NËNSHKRIMI**

Sot, para meje Notere ANILA HAXHIU, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore VLORË, me zyrë në adresën Fier, Lagjia 29 Nentori, Rruga Kastriot Muco, Godina 1, u paraqit personalisht:

**NËNSHKRUES/IT:**

Bujar Hoxha, atësia Beqir, amësia Hasime, shtetas Shqiptar, lindur në Neshtë, Librazhd dhe banues në Fier, me adresë Baltez; Nd. 122; H. 0; Ap. 0; Dërmenas; Dërmenas; 9309; Fier, lindur më 25/05/1976, gjendja civile “i martuar”, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 037667730 dhe nr. personal H60525024P

**NËNSHKRUES/IT:**

Valdrin Pjetri, atësia Luigj, amësia Drande, shtetas Shqiptar, lindur në Shkodër dhe banues në TIRANË, me adresë Shehinfa Solar ” sh.p.k., bashkëlidhur, i perfaqesuar me prokuren e posacme, te redaktuar nga kjo zyre noterie me nr. rep.392, kol 310, date 26.01.2022, nga i besuari i tij, Z. Bujar Hoxha, atësia Beqir, amësia Hasime, shtetas Shqiptar, lindur në Neshtë, Librazhd dhe banues në Fier, me adresë Baltez; Nd. 122; H. 0; Ap. 0; Dërmenas; Dërmenas; 9309; Fier, lindur më 25/05/1976, gjendja civile “i martuar”, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 037667730 dhe nr. personal H60525024P.

Unë Noter/ja, pasi verifikova identitetin e personave të sipërcituar, nëpërmjet mjeteve të identifikimit në përputhje të plotë me nenin 62, pika 1, gërrma “ë”, si dhe nenit 128 të ligjit nr. 110/2018 “Për Noterinë”, dhe Udhëzimit të Ministrisë së Drejtësisë nr. 6291, datë 17.08.2005; vërtetoj nënshkrimin e tyre.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave Personale”, unë noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjektit të këtij veprimi në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

**NOTER**

**ANILA HAXHIU**





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË  
DEGA VENDORE VLORË**

**NOTER ANILA HAXHIU  
ADRESA Lagjia 29 Nentori, Rruga  
Kastriot Muco, Godina 1  
TEL: 0696585135**

## **PROKURË E POSAÇME**

**Nr. repertori: 392**

**Nr. koleksioni: 310**

**Fier më 26/01/2022**

Ligjet referuese:

- 1.Ligi nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligi nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligi nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë"



A2022062450037033002

## PROKURË E POSAÇME



A2022062450037033002

Sët, para meje Notere ANILA HAXHIU, anëtarë në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore VLORE, me zyrë në adresën Fier, Lagjia 29 Nentori, Rruga Kastriot Muco, Godina 1, u paraqit personalisht:

(I/E) PERFAQESUAR: Valdrin Pjetri, atësia Luigj, amësia Drande, shtetas Shqiptar, lindur në Shkodër dhe banues në TIRANË, me adresë Sheh Ahmet Pazar; Nd. 2; H. 1; Ap. 47; Njësia Administrative Nr. 2; Njësia Bashkiake Nr. 2; 1010; Tiranë, lindur më 18/09/1982, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 033406193 dhe nr. personal I20918140C

I cili me dëshirë të lirë, vullnet të plotë dhe të pa vesuar, kërkoi nga unë Noterja redaktimin e kësaj prokure të posaçme në bazë të neneve nr. 64, 70 e vijues të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, nen 62, nen 99 i ligjit 110/2018 "Për Noterinë", si më poshtë vijon:

Une i perfaquesuari i mesiperm Valdrin Pjetri, emeroj perfaquesues te posacem te besuarin tim Bujar Hoxha, i datelindjes 25.05.1976, lindur ne Neshtë, mbajtes i leternjoftimit me personal nr. H'60525024P , i cili ka keto te drejta dhe detyrime, ne lidhje me themelimin dhe regjistrimin e shoqerise tregtare qe une i perfaquesuari dhe perfaquesuesi im kemi vendosur te themelojme me vullnetin te lire :

- Ka te dreje te perfaquesimi parane cdo zyre noterie per te nenshkruar ne emrin tim akt themelimi ddhe statut, te shoqerise cdo akt notarial qe ka te beje me krijimin e shoqerise, qe une dhe i besuari im „perfaquesuesi i posacem“, kemi vendosur te themelojme, me adresë te Fshati Mbrostar Ferko, Rruga Fier – Celigrad, km 2, godine dykateshe, me nr.pasurie 65/19, duke i dhene te drejte te besuarit tim te percaktoj emrin tregtar te shoqerise, formen ligjore, objektin e aktivitetit, afatin kohor, te emerimit te administratorit , kurse per sa i perket perqindjes ne pjesmarje ne kapital ajo do te jete i besuari Bujar Hoxha, do te kete 67 % dhe une i perfaquesuari 33 % te pjesmarjes ne kapital .

-Ka te dreje te perfaquesimit prane QKB Bashkia Fier, ose asaj kompentente, per te ndjekur cdo proceduren ligjore ne lidhje me regjistrimin e kesaj shoqerie , duke i dhene te drejte te nenshkruaj cdo kerkese, aplikimi, te depozitoj aktin dhe statusin e themelimit si dhe cdo dokumenti te nevojshem.

-Kjo procure eshte pa afat.

Aktin pasi e lexova, e kuptova dhe rashe dakord me permbytjen e procures se mesiperme, e nenshkrova perpara noteres me vullnet te lire dhe pa verejtje.

Une noterja, pas nenshkrimit te perfaquesuares perpara meje, e konfirmova aktin ne tre kopje me te njejtën vlerë perdonimi, njera prej te cilave e arkivova prane kesaj zyre, duke e vertetuar ne baze te neneve 70-75 te Kodit Civil Shqiptar.

(I/E) PERFAQESUAR

Valdrin Pjetri

N O T E R

ANILA HAXHIU

Valdrin Pjetri  




Fq. 1


AKT - THEMELIMI

I SHOQERISE TREGTARE

**“INFRA SOLAR” SHPK**

SELIA FIER

JANAR 2022



## **AKT - THEMELIMI PER KRIJIMIN E SHOQERISE TREGTARE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR “INFRA SOLAR” SHPK**

Sot me date 26.01.2022 , diten e **merkure** , Z.Valdrin Pjetri , i datelindjes 18.09.1982, lindur ne Shkodër,mbajtes i leternjoftimit me personal nr. I20918140C dhe Z.Bujar Hoxha, i datelidnjes 25.05.1976, lindur ne Neshtë, mbajte i leternjoftimit me personal nr. H60425024P , me iniciativen tone te lire si dhe duke u bazuar ne Kushtetuten e Republikes se Shqiperise , Kodin Civil ne fuqi , ne mbeshtetje te Ligjt nr. 9901 date 14.04.2008 “Per Shoqerite Tregetare” , ligjt nr. 9723 date 03.05.2007 « Per Qendren Kombetare te regjistrimit », ligji nr.10475, date 27.10.2011 "Per disa ndryshime ne ligjin 9901 date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare" , ligji nr.129 2014 "Per disa shtesa dhe ndryshime ne Ligjin Nr.9901, date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare "te ndryshuar , ligji nr.110/2012 "Per bashkimin nderkufttar te shoqerive tregtare". si dhe , ate Doganor , Fiskal , Tatimor, me ndryshimet perkatese, vendosem te krijojme shoqerine shqiptare me perqejegjesi te kufizuar per sa me poshte vijon :

### **Neni 1 EMERTIMI I SHOQERISE**

Te formohet shoqeria tregetare shqiptare me perqejegjesi te kufizuar me emertimin **“ Infra Solar ” sh.p.k.**

### **Neni 2 KOHEZGJATJA E VEPRIMTARISE**

Shoqeria , krijohet per te ushtruar veprimtarine e saj per nje periudhe kohe te pakufizuar, mbi dhjete vjete pune te njepasnjeshme.

Ky afat mund te shkurtohet per rastet kur shoqeria do te shperbehet sipas percaktimeve qe do te pasqyrohen ne Statut.

### **Neni 3 QENDRA E SHOQERISE**

Shoqeria **“ Infra Solar ” SHPK**, do te kete qendren ( seline ) e saj ne territorin e Republikes se Shqiperise , ne adresen : Rrethi Fier , Bashkia Fier , Lagja "Mbrostar Ferko" Rruga "Fier Celograd » Km 2, Godine dykateshe, me nr.pasurie 65/19.

### **Neni 4 OBJEKTI I VEPRIMTARISE**

Objekti i veprimtarise se shoqerise do te jete :

**Shoqeria krijohet per të ushtruar aktivitetin e saj tregtar ne keto drejtime :**

**Shoqeria tregtare private “ Infra Solar ” sh.p.k., ka për objekt të veprimtarisë së saj:**

Implementimi dhe menaxhimi i projekteve gjeneruese te energjise elektrike solare (fotovoltaik) dhe energjise se eres (eolike) ne Republiken e Shqiperise dhe marrja nga Qeveria Shqiptare apo Ministrire e Institucioneve te Shtetit Shqiptar i te gjitha miratimeve, lejeve dhe licensave te cilat mundesojne zhvillimin e ketij aktiviteti ne menyre te qete dhe ne perputhje me kuadrin ligjor ne Republiken e Shqiperise. Implementimi dhe menaxhimi i projekteve ne fushen e akuakultures dhe bujqesise si dhe veprave ndihmese qe lidhen me to , prodhimi, kultivimi, perpunimi, grumbullimi, transporti i produkteve te akuakultures. Import eksport te gjitha llojeve te materialeve dhe transport.

Konsulenca teknike ne te gjitha fushat.



Shoqeria ka te drejte te ushtroje çdo lloj aktiviteti te parashikuar nga ligji ne perputhje me rregullat e dispozitat ne fuqi. Shoqeria do te ushtroje aktivitetin e saj ne baze te autorizimeve dhe/ose lejeve perkatese te leshuara nga organet kompetente te fushes".

### Neni 5 REGJIMI JURIDIK

Ne te gjithe territorin e saj ne Republiken e Shqiperise Shoqeria do te udhehiqet nga legjislacioni shqiptar ne fuqi.

Te drejtat dhe detyrimet e shoqerise dhe te ortakeve te saj percaktohen me hollesisht ne Statutin qe i bashkengjitet ketij Akti.

Shoqeria gezon mbrojtje dhe sigurim te plote ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi.

Per evidentimin e veprimtarise se Shoqerise do te perdoren dispozitat ligjore ne fuqi, dhe kerkesat e pergjitheshme te kontabilitetit, sic sqarohet me hollesisht ne dispozitat perkatese te Statutit te Shoqerise.

Shoqeria fillon veprimtarine e saj vetem pasi te kete marre autorizimin e organeve kompetente sipas legjislacionit ne fuqi .

### Neni 6 ORTAKU THEMELUES

Themelues i shoqerise eshte ortaku Valdrin Pjetri, me 33 (tridhjete e tre) % pjesëmarrje në përqindje, dhe ortaku Bujar Hoxha, me 67 (gjashtedhjete e shtate) % pjesëmarrje në përqindje te kuotave te shoqerise.

### Neni 7 KAPITALI I SHOQERISE

7/1 Kapitali baze i Shoqerise eshte ne para: 150.000 (njeqind e pesedhjete mijë) leke, ortaku Valdrin Pjetri, me 33 (tridhjete e tre) % pjesëmarrje në përqindje, dhe ortaku Bujar Hoxha, me 67 (gjashtedhjete e shtate) % pjesëmarrje në përqindje te kuotave te shoqerise.

Kontributi i ortakeve eshte në para dhe do te paguhet mbas regjistrimit te kesaj shoqerie ne QKB.

Ortaket per gjigjen per humbjet e shoqerise perkundrejt te treteve deri ne vleren e kontributit te tyre ne kapitalin themeltar te shoqerise;

7/2 Kapitali i shoqerise do te rritet krahas ecurise se saj ekonomike , financiare si dhe te vendimeve qe do te marrin ortaket eshoqeriseper ta rritur ate ne te ardhmen

7/3 Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme me rruge trashegimie , ne rast ndarje pasurore mes bashkeshorteve dhe nepermjet paraardhesve e pasardhesve sipas legjislacionit ne fuqi ne Republiken e Shqiperise.

7/4 Fitimi i shoqërisë i përket tërësisht ortakeve të shoqërisë .

Ky fitim do të disponohet lirisht prej tyre , ne baze te raportit te kontributit te tyre ne kapitalin themeltar, pasi të jenë shlyer më parë detyrimet tatusese fiskale dhe ato ndaj të tretëve dhe te jene hequr 5% qe do te futet ne fondin e rezerves ligjore deri ne permbushjen e 1\10 te kapitalit te shoqerise .

### Neni 8 DREJTAMI I SHOQERISE

8 Organ drejtues dhe vendimor në këtë shoqëri është mbleasambleja e ortakeve.

8/1 Asambleja e ortakeve, merr vendime te zakonshme ose te jashte zakonshme sipas disponimeve te statutit te shoqerise .

8/2 Shoqeria do te administrohet nga Administratori i saj Z.Bujar Hoxha, me atesi Beqir, i datelindjes 25.05.1976, lindur ne Neshtë, mbajtes i leternjoftimit me personal nr.H60525024P, i cili do te kete kete detyre per nje periudhe 5 (pesë) vjecare, me te drejte rizgjedhje .

Administratori e përfaqëson juridikisht atë në gjitha organet apo organizmat e aparatit shtetëror dhe në marrëdhëniet me të tretët, kur veprimet kanë të bëjnë me disponimin e interesave materiale të shoqërisë.

8/3 Per cdo ceshtje profesionale, si juridike, ekonomike, teknike etj , shoqeria do te angazhoje sipas rastit ne menyre te vijueshme ose te perkoheshme duke punesuar specialist sipas legjislacionit ne fuqi .

**Neni 9**  
**SIGURIMI I PASURISE SE SHOQERISE**

9/1 Pasuria e shoqerise do te sigurohet ne Institutin e Sigurimeve te Republikes si dhe ne institute te tjera private ekzistuese apo qe do te krijohen ne te ardhmen sipas legjislacionit ne fuqi .

9/2 Masa e pasurise qe do te sigurohet si dhe koha e sigurimit te saj do te vendoset nga Administatori .

**Neni 10**  
**MBYLLJA EKONOMIKE VJETORE E SHOQERISE**

Si rregull, veprimet ekonomike te shoqërisë do të mbyllen më 31 dhjetor të çdo viti.  
Përjashtim nga ky rregull do tëbëhet kur e kërkon organi kompetent ligjor.

**Neni 11**  
**LIKUJDIMI I SHOQERISE**

Shoqëria do të shpërbëhet sipas rasteve që do të përcaktohen në statutin e saj.

**Neni 12**  
**DISPOZITA TE PERGJITHSHME**

12/1 Ky akt per themelimin e Shoqerise ka si pjese te saj edhe Statutin e Shoqerise i cili bashkengjitet dhe depozitohet sipas dispozitave ligjore ne fuqi.

12/2 Ne rastet e likujdimit perfundimtar te Shoqerise , sipas legjislacionit ne fuqi ,pushon se vepruar edhe ky Akt - Themelimi .

12/3 Adresa ligjore e shoqerise eshte : Rrethi Fier , Bashkia Fier , Lagja "Mbrostar Ferko" Rruga "Fier Celigrad » Km 2, Godine dykateshe, me nr.pasurie 65/19.

12/4 Çdo ndryshim apo shtese qe mund ti behet ketij Akti per Themelimin e saj duhet te behet me shkrim ,te nenshkruehet nga ortaket e saj dhe te depozitohet si ne dokumentat e shoqerise qe mbahen ne Qendren e saj,ashtu edhe ne QKB perkatese .

12/5 Te gjitha mosmarreveshjet qe nuk mund te zgjidhen me mirkuptim , do te paraqiten per zgjidhje ne Gjykatën kompetente Shqiptare ne perputhje me legjislacionin ne fuqi .

Ky Akt Themelimi i shoqerise u printua ne kater kopje te barabarta dhe u nenshkruehet nga une ortaku i vetem i saj me vullnet te lire dhe te plote .

**ORTAKET E SHOQERISE**

Valdrin Pjetri perfaqesuar nga i besuari Bujar Hoxha

Bujar Hoxha

Bujar Hoxha BH



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË  
DEGA VENDORE VLORË

NOTER ANILA HAXHIU  
ADRESA Lagjia 29 Nentori, Rruga  
Kastriot Muco, Godina 1  
TEL: 0696585135

## VERETIM NENSHKRIMI (AKT THEMELIMI)

Nr. repertori: 395

Fier më 26/01/2022

Ligjet referuese:

- 1.Ligi nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligi nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligi nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë"



V2022062450008415147

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË**  
**DEGA VENDORE VLORË**  
**NOTER ANILA HAXHIU**



**DATE 26/01/2022**  
**NR REP. 395**

**VËRTETIM NËNSHKRIMI**

Sot, para meje Notere ANILA HAXHIU, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore VLORË, me zyrë në adresën Fier, Lagjia 29 Nentori, Rruga Kastriot Muco, Godina 1, u paraqit personalisht:

**NËNSHKRUES/IT:**

Bujar Hoxha, atësia Beqir, amësia Hasime, shtetas Shqiptar, lindur në Neshtë, Librazhd dhe banues në Fier, me adresë Baltez; Nd. 122; H. 0; Ap. 0; Dërmenas; Dërmenas; 9309; Fier, lindur më 25/05/1976, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 037667730 dhe nr. personal H60525024P

**NËNSHKRUES/IT:**

Valdrin Pjetri, atësia Luigj, amësia Drande, shtetas Shqiptar, lindur në Shkodër dhe banues në TIRANË, me adresë Shehinfa Solar " sh.p.k., bashkëlidhur, i perfaqesuar me prokuren e posacme, te redaktuar nga kjo zyre noterie me nr. rep.392, kol 310, date 26.01.2022, nga i besuari i tij, Z. Bujar Hoxha, atësia Beqir, amësia Hasime, shtetas Shqiptar, lindur në Neshtë, Librazhd dhe banues në Fier, me adresë Baltez; Nd. 122; H. 0; Ap. 0; Dërmenas; Dërmenas; 9309; Fier, lindur më 25/05/1976, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 037667730 dhe nr. personal H60525024P.

te mesiperpermendurit nenhskraun perpara meje akt themelimi te shoqerise "Infra Solar", te themeluar nga kerkuesit e mesiperm

Unë Noter/ja, pasi verifikova identitetin e personave të sipërcituar, nëpërmjet mjeteve të identifikimit në përputhje të plotë me nenin 62, pika 1, gërmë "ë", si dhe nenit 128 të ligjit nr. 110/2018 "Për Noterinë", dhe Udhëzimit të Ministrisë së Drejtësisë nr. 6291, datë 17.08.2005; vërtetoj nënshkrimin e tyre.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjektit të këtij veprimi në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

**NOTER**

**ANILA HAXHIU**

